



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 23/2022 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 23 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

**Gentian MEDJA - Kryesues
Arbena AHMETI - Anëtare
Asim VOKSHI - Anëtar**

më datë 24.11.2022, mori në shqyrtim kërkesën administrative nr. 23/2022, që u përket palëve:

KËRKUES: Diana Brahim Muço

OBJEKTI: Konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyehmë, të parashikuar nga shkronja a) e nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile; neni 48/ 2 të ligjit nr. 49/ 2012, datë 03.05.2012 të çështjes administrative për ndreqje vendimi të regjistruar në Gjykatën e Apelit Administrativ në vitin 2020 dhe detyrimin e kësaj gjykate për përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Marrja e informacionit të nevojshëm për këtë çështje nga na juaj kësaj gjykate në bazë të nenit 399/ 4, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile.

BAZA LIGJORE: Neni 42/ 1, 42/ 2 dhe 43 i Kushtetutës; Neni 6/ 1 dhe 8 i KEDNJ; Ligji nr. 98/ 2016; shkronja d) e nenit 399/ 2, paragrafi 1 i nenit 399/ 4, neni 399/ 5, pika 1, shkronja c) e nenit 399/ 8 të Kodit të Procedurës Civile. Ligji nr. 49/ 2012; dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 251, datë 20.11.2017.

në çështjen administrative me palë:

KËRKUES: Diana Muço

PERSONA TË TRETË: Ministria e Financave,

Dega e Thesarit Vlorë,
Ministria e Shëndetësisë,
Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë

OBJEKTI: Ndreqja e gabimeve vendimi nr. 337, datë 13.02.2020 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në pjesën vendimmarrëse nr. vendimit dhe data e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë nr. vendimit 1953 (84-2016-2236), datë 25.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë nr. vendimi 1970, datë 01.12.2016.

BAZA LIGJORE: Nenet 312, 102 deri 106 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, Urdhër nr. 1830, datë 03.04.2001 i Ministrit të Drejtësisë për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, Gentian Medja dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes.

1. Rezulton se kërkuesja (palë paditëse) Diana Muço është punësuar pranë palës së paditur Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me detyrën "Mjeke Psikiatre".

2. Me shkresën urdhrin nr.239, me nr. 2200 prot datë 31.05.2012 të nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë, është vendosur pezullimi nga detyra i paditëses deri në vendimin e prokurorisë.

3. Me vendimin nr.314 datë 03.07.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi kërkesën e bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur caktimin e masës ndaluese ndaj paditëses "*pezullimi i ushtrimit të detyrës publike*" parashikuar nga neni 242 i Kodit Procedures Penale.

4. Rezulton se me vendimin nr.498 datë 04.10.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur shuarjen e masës ndaluese pezullimi i ushtrimit të detyrës publike, si mjeke pranë Spitalit Psikiatrik Vlore, masë ndaluese e parashikuar nga neni 242 i Kodit Procedurës Penale, dhënë me vendimin nr.314 datë 03.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5. Me shkresën me nr.10321 prot., datë 09.10.2012 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë i është dërguar palës së paditur Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë urdhri i ekzekutimit për vendimin nr.498 datë 04.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me anë e të cilit është hequr masa ndaluese pezullimi i ushtrimit të detyrës publike për Diana BrahimMuco, si mjeke pranë Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë.

6. Me urdhrin nr.576, me nr.4820 prot datë 13.11.2012 nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë, është vendosur "*kthimi i mjekes Diana BrahimMuco në vendin e mëparshëm të punës në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë*".

7. Rezulton se pala paditëse Diana BrahimMuço është marrë e pandehur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e akuzuar për veprën penale "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe është

depozituar kërkesa për gjykimin e saj, ku me vendimin nr.187 datë 08.05.2013 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur *"deklarimin e pafajshëm të të pandehurës Diana BrahimMuço për veprën penale të "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal"*, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.175 datë 24.03.2016.

8. Në këto kushte paditësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me padinë me objekt *"kërkohet shpërblimi i dëmit si rezultat akteve të paligjshëm të Organeve Shtetërore në masën e pagës së papaguar për periudhën 31.05.2012 deri në 19.11.2012."*

9. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë**, me vendim nr. 1970 datë 01.12.2016 ka vendosur: *"Pranimin e kërkesë – padisë. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Shëndetësisë dhe Spitali Psikiatrik Ali Mihali Vlorë ti paguajë paditëses Diana Brahim Muço pagën për periudhën 31.05.2012 deri në 03.07.2012 dhe 05.10.2012 deri në 13.11.2012. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Financave dhe Dega e Thesarit Vlorë ti paguajë paditëses Diana Brahim Muço pagën për periudhën 04.07.2012 deri në 04.10.2012. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen në mënyrë të barabartë palëve të paditura. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Shërbimi Përmbarimor. Ky vendim duhet të ekzekutohet brenda një afati 3 muaj nga dita që vendimi merr formë të prerë dhe me një kësht të vetëm. Kundër këtij vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. U shpall në Vlorë, sot më datë 01.12.2016."*

10. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 337 (86-2020-373) datë 13.02.2020 ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 1953 (84-2016-2236), datë 25.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të tij. U shpall në Tiranë, sot më 13.02.2020."*

11. Në vijim rezulton se, prej Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në shqyrtim kërkesa për ndreqjen e gabimit (objekt si më sipër cituar) dhe se kjo gjykatë me vendim nr. 60 datë 24.09.2020 ka vendosur: *"Pranimin e kërkesës. Ndreqjen e gabimit të bërë në pjesën urdhëruese të vendimit nr. 337 (86-2020-373) datë 13.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit përsa i përket numrit të vendimit të ankimuar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga nr. 3812 (80-2016-3831) datë 19.07.2016" në atë të saktë "nr. 4955 (80-2016-4989) datë 25.10.2016". Urdhërohet bashkëngjitja e këtij vendimi me vendimin e ndrequr nr. 337 (86-2020-373) datë 13.02.2020 të kësaj gjykate. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë. Tiranë, sot më 24.09.2020."*

12. Pala kërkuese, në datë 12.01.2021, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesën me objekt *"Ndreqja e gabimeve vendimit për Ndreqje vendimi nr. 60 datë 24.09.2020 nga I. Ndreqjen e gabimit të bërë në pjesën urdhëruese të vendimit nr. 337 (86-2020-373) datë 13.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit përsa i përket numrit të vendimit të ankimuar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga nr. 3812 (80-2016-3831) datë 19.07.2016" në atë të saktë "nr. 4955 (80-2016-4989) datë 25.10.2016". Në "Ndreqja e gabimeve vendimit nr. 337 datë 13.02.2020 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në pjesën vendimmarrëse nr. vendimit dhe data e vendimit të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Vlorë nga nr. vendimi "nr. 3812 (80-2016-3831) datë 19.07.2016" në atë të saktë "nr. 4955 (80-2016-4989) datë 25.10.2016". Në Ndreqja e vendimit nr. 337 datë 13.02.2020 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në pjesën vendimmarrëse nr. vendimit dhe data e vendimit të Gjykatës Administrative Shkalla e Par Vlorë nga nr. vendimi 1953 (84-2016-2236), datë 25.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në nr. vendimi 1970 datë 01.12.2016. Pra ndreqja e nr. të vendimit sipas boldimit të bërë më sipër."*

13. Me datë 30.05.2022 kërkuesja i është drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatim të shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes administrative për ndreqje vendimi të regjistruar në Gjykatën e Apelit Administrativ në vitin 2020 dhe detyrimin e kësaj gjykate për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, me palë kërkues Diana Muço, persona të tretë Ministria e Financave, Dega e Thesarit Vlorë, Ministria e Shëndetësisë, Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë. Në përmbajtje të kësaj kërkesë pretendohet:

- Në Gjykatën Administrative të Apelit në vitin 2020 është dhënë vendimi por është gabuar në pjesën vendimmarrëse numri vendimit i Gjykatës së Shkallës së Parë për të cilin është bërë kërkesë për korrigjim dhe përsëri është shënuar gabim ky numër ku më tej në vitin 2020 është bërë kërkesë tjetër korrigjimi dhe qysh atëherë e deri tani nuk po zhvillohet ky gjykim që është çështje e veçantë dhe afatet kohore janë shumë të shkurtra.
- Me vendimin nr. 337 datë 13.02.2020, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 1953 (84-2016-2236), datë 25.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Pas dhënies së vendimit është bërë kërkesë për ndreqje vendimi dhe në gjykimin e kësaj kërkesë përsëri është bërë i njëjti gabim në nr. vendimit të Gjykatës.
- Për këtë përsëri me kërkesë në vitin 2020 i jemi drejtuar Gjykatës për ndreqje të këtij gabimi dhe qysh nga ajo kohë kjo çështje nuk është gjykuar.
- Nga ana e Gjykatës është bërë gabim material në numrin e vendimit të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Vlorë ku është shprehur për një nr. tjetër vendimi dhe datë tjetër që bie ndesh edhe me arsyetimin e vendimit, gjë që duhet të korrigjohet pasi bëhet pengesë për ekzekutimin e këtij vendimi.
- Nisur nga sa më sipër kërkohet konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga shkronja a) e nenit 399/ 2 të Kodit të Procedurës Civile; neni 48/ 2 të ligjit nr. 49/ 2012, datë 03.05.2012 të çështjes administrative për ndreqje vendimi të regjistruar në Gjykatën e Apelit Administrativ në vitin 2020 dhe detyrimin e kësaj gjykate për përshpejtimin e gjykimit të çështjes.”

14. Me shkresë protokolluar në Gjykatë me nr. 4255 datë 12.09.2022 “Dërgim kërkesë të kërkueses Diana Brahim Muço”, Gjykata Administrative e Apelit i ka përcjellë Gjykatës së Lartë *“...kërkesën e kërkueses si dhe fotokopjen e njehsuar me origjinalin të dosjes nr. 100 regj. them. datë 12.01.2021 me objekt: Ndreqja e gabimeve të vendimit për ndreqje vendimi nr. 60 dtë 24.09.2020. Kjo çështje ka qenë për gjykim pranë gjyqtare relatorë Rilinda Selimi e cila është shkarkuar më datë 22.06.2022 me vendim të KPA.”*

15. Po ashtu, me shkresë nr. 1449/1 prot., datë 28.09.2022, protokolluar në gjykatë me nr. 4785/1 prot., datë 30.09.2022, Gjykata Administrative e Apelit i ka përcjellë Gjykatës së Lartë “Dhënie mendimi”, e cila përmban për sa më poshtë: *“Çështja në fjalë është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 12.01.2021. Relatore e kësaj çështje rezulton të ketë qenë gjyqtare Rilinda Selimi. Nga verifikimi akteve procedurale të dosjes gjyqësore, rezulton se kjo çështje nuk është planifikuar për gjykim prej saj. Gjyqtare Rilinda Selimi nuk e ushtron më funksionin gjyqësor, për shkak të shkarkimit nga detyra me vendimin nr. 22, datë 22.06.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në vijim, me shortin manual të datës 16.09.2022 jam caktuar unë, gjyqtare Altina Nasufi në cilësinë e gjyqtares relatore. Pas caktimit të kësaj çështje për gjykim, nga ana ime si gjyqtare relatore janë marrë menjëherë të gjitha masat për plotësimin e trupit gjyqësor dhe planifikimin e kësaj çështje për gjykim. Çështja është planifikuar për shqyrtim në dhomë këshillimi me datë 05.10.2022 ora 12:55.”*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

17. Kolegji konstaton se kërkesa është paraqitur nga një subjekt i legjitimuar. Kërkesja rezulton të jenë në cilësinë e palës kërkuese në procesin gjyqësor për të cilin është regjistruar çështja me nr. regjistri themeltar 100, datë regjistrimi 12.01.2021 pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

18. Kërkesa është në kompetencën e këtij Kolegji, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile si dhe është e shoqëruar me të gjitha aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuar në nenin 399/5, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile.

19. Parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ, pasi përbën dhe një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim bazohet në postulatit “*Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*”. Shkalla e respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*).

20. Në praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), e cila ka përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

21. Në vijim, të jurisprudencës së konsoliduar GJEDNJ ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Në referim të saj, rezulton se në përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të ndryshëm, të tilla si: kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr. 50719\06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*).

22. Në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes, merr në konsideratë të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedure. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë dt. 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*).

23. Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit. Diligjencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti vlerëson gjykata, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, dt. 15.07.1982 të GJEDNJ*).

24. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqe të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në dukje si p.sh.:

bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkaktuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligjzbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. *(Shih vendimin Eëing kundër Mbretërisë së Bashkua.*

25. Në çështjen objekt gjykimi, konstatohet se në momentin e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën Administrative të Apelit, çështja ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (1 vit), pasi nga regjistrimi i çështjes (12.01.2021) dhe deri në paraqitjen e kësaj kërkesë pranë Gjykatës së Lartë (12.09.2022) ka kaluar një kohë mbi një vit.

26. Duke marrë në vlerësim standardet e përcaktuar nga jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me afatin arsyeshëm nuk rezulton se që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, të jetë shtyrë gjykimi për shkak të kërkesave të palës kërkuese. Çështja nuk paraqitet komplekse nga natyra e saj, pasi objekt kërkimi është korrigjimi i një gabimi material në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

27. Përmes shkresës nr. 4785/1, datë 30.09.2022, gjyqtari relator ka përcjellw mendimin mbi shqyrtimin e çështjes administrative nr. 100 regj. theml, datë 12.01.2021, ku ka parashtruar se janë marrë masa të menjëhershme për plotësimin e trupit gjykues dhe planifikimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi në datë 05.10.2022. Në kushtet kur çështja e themelit është planifikuar për shqyrtim nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, Kolegji vlerwson se çështja me objekt shqyrtimin e kërkesës së konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave ka mbetur pa objekt. Në këto kushte gjykimi i kësaj kërkesë në Gjykatën e Lartë duhet të pushohet bazuar në pikën 3 të nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se “3. Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimi i kërkesës.”.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit nenit 399/7 pika 3 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Pushimin e gjykimit të kërkesës nr. 23/2022, të kërkuetit Diana Brahim Muço.

Tiranë, më 24.11.2022